



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 937/ 15 prot.

Datë 27.05.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 712 /2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                |         |
|----------------|---------|
| Jonaïd Myzyri  | Kryetar |
| Anila Malaj    | Anëtar  |
| Gjergj Mersini | Anëtar  |

Në mbledhjen e datës 27.05.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.662/2025, datë 14.05.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Loti II** me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “Blerje tonera ”, me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK me Nipt, K81503063B, Adresa:Rr: Faik Konica, Ndërtesa nr.3, Hyrja 7, Tiranë.

Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” ShPK, me Nipt L91418502J, Adresa: Z.Kadastrale nr.8517, Ndërtese 4 kate, me sip. trualli 1000 m<sup>2</sup>, Durrës.

**Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “ERVIN LUZI” P.F, me Nipt. K71707007Q, Adresa: Lagjja:Katund i Ri, Rr. Ali Pashë Gucia, Nr. 5,Yrshek, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës.  
Adresa: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 14.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.662/2025, ku vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Loti II** me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “Blerje tonera”, me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.*
  2. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.*
  3. *Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KSHA-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F.*
  4. *Ngarkohet zyra e financës që të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK.*
  5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” ShPK*
  6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.*
  7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën ardhur me e-mail protokolluar me tonën me nr. 937/12, datë 27.05.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 662/2025 datë 14.05.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

**II**

**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

**Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr.131/52 prot., datë 22.04.2025, protokolluar me tonën nr. 707/7, datë 24.04.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 482/2025 datë 11.04.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi

II.2. Referuar shkresës sipërcituar nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer njoftim fituesin duke lënë në fuqi Vendimin e KVO-së për procedurën e prokurimit në përputhje me vendimin e KPP-së.

II.3. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës ka zbatuar vendimin Nr. 662/2025 datë 14.05.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Loti II** me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “Blerje tonera ", me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Loti II** me Nr. REF-39862-03-04-2025, me objekt “Blerje tonera ", me fond limit 3.956.668 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 17.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
  2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Anëtar**

**Gjergj Mersini**

**Kryetar**

**Jonaïd Myzyri**

